


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2022

Tiranë, më 17 Gusht 2022: Në Korrik 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 39 mld lekë, duke u rritur me 23,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 14,3 %, në krahasim me Qershor 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 82 mld lekë, duke u rritur me 14,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 0,6 %, në krahasim me Qershor 2022. Deficiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u rritur me 6,9 %, krahasuar me Korrik 2021 dhe me 20,3 %, në krahasim me Qershor 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë shtatëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 293 mld lekë, duke u rritur me 40,1 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 528 mld lekë, duke u rritur me 23,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 235 mld lekë, duke u rritur me 8,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Korrik 2022, në rritjen e eksporteve prej 23,0 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Tekstile dhe këpucë" me +6,6 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me +5,2 pikë përqindje dhe "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +5,0 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2022




Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë rritur me 40,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +12,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,1 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,9 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Korrik 2022, në rritjen e importeve prej 14,1 %, krahasuar me Korrik 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,6 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +2,5 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2022



Si shtatëmujor, importet janë rritur me 23,9 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,4 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +3,7 pikë përqindje. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “ Të tjera” me -0,2 pikë përqindje

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2021 janë: Itali (35,2 %), Greqi (4,8 %) dhe Austri (248,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (12,1 %) Spanja (20,8 %) dhe Gjermania (2,2 %).

Gjatë këtij shtatëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (50,9 %), Kosova (8,4 %) dhe Gjermania (79,3 %) . Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Spanja (46,7 %) .

Në muajin Korrik 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2021 janë: Italia (7,2 %), Turqia (5,2 %) dhe Kina (12,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania (3,9 %) , Kosova (3,0 %) dhe SHBA (71,7 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (12,8 %), Turqia (35,4 %) dhe Kina (8,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (30,3 %), Rusia (21,7 %) dhe Zvicra (14,0 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2022



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 62,5 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,7 %), Greqia (7,2 %), Kina (6,1 %) dhe Turqia (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmuajorin 2022, me vendet e BE-së zënë 60,6 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,3 %), Turqia (8,0 %), Greqia (6,8 %) dhe Gjermania (6,4 %) .

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Korrik 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	Janar-Korrik 19	180	-2,6	377	2,6	-197	47,7
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	Janar-Korrik 20	150	-16,7	328	-13,1	-178	45,7
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	Janar - Korrik 21	209	39,2	426	29,8	-217	49,0
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	Janar-Korrik 22	293	40,1	528	23,9	-235	55,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Korrik 2022

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2021	Korrik 2022	Jan, - Korrik 2021	Jan, - Korrik 2022	Korrik 2021	Korrik 2022	Jan, - Korrik 2021	Jan, - Korrik 2022
Vendet e BE-së	23.599	30.816	151.141	216.316	38.532	44.866	234.886	280.350
Austri	226	788	1.361	2.875	523	583	3.681	3.888
Gjermani	1.777	1.737	11.287	20.235	5.129	4.930	30.766	32.597
Greqi	2.028	2.126	12.055	16.054	5.590	6.593	32.695	39.901
Itali	13.549	18.321	88.829	134.015	17.574	18.837	108.989	122.916
Spanjë	2.239	1.773	14.015	7.473	1.121	1.830	6.196	8.759
Kroaci	184	401	1.667	4.757	794	1.246	4.384	5.268
Të tjera të BE-së	3.596	5.669	21.926	30.907	7.799	10.847	48.176	67.021
Mbretëri e Bashkuar	109	149	418	1.282	798	748	3.627	4.434
Kinë	314	316	4.130	7.287	6.316	7.097	37.387	40.593
Kosovë	3.117	2.740	20.368	22.085	1.548	1.502	6.681	9.070
Maqedonia e Veriut	1.129	1.073	6.881	10.060	1.082	981	6.451	8.685
Rusi	-	-	8	12	1.040	639	8.082	6.325
SHBA	637	720	2.762	6.016	4.040	1.142	10.188	7.104
Turqi	586	253	3.614	3.696	6.772	7.124	45.915	62.168
Ukrainë	36	85	201	358	264	302	2.108	2.344
Zvicër	175	75	1.517	2.341	643	782	5.288	4.546
Të tjera	2.390	3.233	17.683	23.069	10.542	16.483	65.175	102.082
Gjithsej	32.093	39.461	208.723	292.523	71.578	81.666	425.787	527.701

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Korrik 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2021	Korrik 2022	Jan, - Korrik 2021	Jan, - Korrik 2022	Korrik 2021	Korrik 2022	Jan, - Korrik 2021	Jan, - Korrik 2022
Gjithsej	32.093	39.461	208.723	292.523	71.578	81.666	425.787	527.701
Ushqime, pije, duhan	3.906	4.000	25.301	29.347	12.186	14.001	69.971	85.546
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	5.360	6.979	40.373	63.597	7.492	13.488	38.893	82.887
Produkte kimike dhe plastike	1.158	1.466	5.879	11.742	10.182	10.902	64.667	67.890
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	172	203	1.188	1.733	1.248	1.521	8.527	10.545
Prodhime druri dhe letre	896	1.309	5.284	8.103	2.394	3.310	15.133	20.491
Tekstile dhe këpucë	10.050	12.162	66.269	80.568	7.673	8.688	50.439	58.821
Materiale ndërtimi dhe metale	7.090	8.751	41.941	67.796	9.028	10.866	60.317	79.087
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.381	3.379	16.418	22.404	16.796	15.967	97.638	102.978
Të tjera	1.079	1.214	6.070	7.231	4.579	2.924	20.204	19.456

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Korrik 2022

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	88.829	134.015	20.368	22.085	11.287	20.235	12.055	16.054
Ushqim, pije duhan	6.184	6.482	2.655	3.291	783	901	2.129	2.256
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.010	16.857	4.894	3.328	3.125	11.566	4.011	2.051
Produkte kimike dhe plastike	1.553	2.824	1.768	2.520	41	35	449	2.792
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.031	1.597	11	9	35	9	9	24
Prodhime druri dhe letre	3.340	4.953	455	791	147	216	762	1.229
Tekstile dhe këpucë	52.088	63.037	112	107	4.511	5.009	3.066	3.436
Materiale ndërtimi dhe metale	12.363	22.710	8.761	10.043	1.062	775	1.257	3.673
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	8.410	11.963	843	1.119	1.332	1.463	61	94
Të tjera	2.851	3.591	869	876	250	261	310	498

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Korrik 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	108.989	122.916	45.915	62.168	37.387	40.593	32.695	39.901
Ushqim, pije duhan	13.449	16.392	4.001	3.761	544	847	9.440	10.825
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	6.113	2.874	3.228	4.081	9	4	4.793	7.072
Produkte kimike dhe plastike	13.656	15.324	6.260	6.999	5.629	4.274	5.427	6.036
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.033	8.424	197	294	404	521	21	20
Prodhime druri dhe letre	3.567	4.536	1.797	3.243	415	649	2.188	2.715
Tekstile dhe këpucë	24.298	30.159	9.948	10.555	6.456	6.329	2.005	2.687
Materiale ndërtimi dhe metale	14.422	16.069	11.374	23.133	3.002	4.667	5.770	6.888
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	22.576	24.472	6.230	7.129	17.385	19.283	1.940	2.718
Të tjera	3.876	4.665	2.881	2.974	3.544	4.018	1.111	940

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri